



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 53

Prishtinë, më 28.3.2019, në orën: 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Valon Ramadani, Arban Abrashi, Imet Rrahmani, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Munguan: Shqipe Pantina, Jasmina Zhivković, Adem Mikullovcic dhe Xhevahire Izma.

Pjesëmarrës të tjerë: KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit;**
- 3. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve të përhershme për Projektligjin nr. 06/L-081, për qasje në dokumentet publike;**
- 4. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit**

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

**3. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve të përhershme për Projektligjin nr. 06/L-081, për qasje në dokumentet publike**

Komisioni shqyrtoi raportet me rekomandime të komisioneve të përhershme për Projektligjin nr. 06/L-081, për qasje në dokumentet publike:

- Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka konstatuar që Projektligji dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- Komisionit për Integritet Evropian, ka konstatuar që Projektligji dhe amendamentet e propozuara nga komisioni funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.
- Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka konstatuar që projektligji dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.
- Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, ka konstatuar që Projektligji dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm. I rekomandohet Komisionit funksional që amendamenti 39, të rishikohet nga Komisioni funksional.

**Konstatim:** Komisioni rishqyrtoi amendamentin 39 dhe nuk e përkrahu rekomandimin e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

#### **4. Të ndryshme**

Komisioni vendosi që në mbledhjen e radhës të ftohen në mbledhje anëtarët e KPM-së.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**

-----

Nait Hasani